



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 19.10.2021

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR POZICIONET
E SHPALLURA NGA AZHBR**

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), në Urdhrin e Kryeministrit nr. 143, datë 03.11.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, në shpalljen “Njoftim Punësimi” nr. 3112 prot, datë 13.10.2021, AZHBR njofton se pas përfundimit të verifikimit të kandidatëve, për përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, njofton se për pozicionin:

➤ **SPECIALIST INFO-APLIKIM AGROPIKA ELBASAN**

(me kontratë pune 8h/ditë, kategoria IV-c)

• **Kandidatët e kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurimit janë:**

1. Enxhina Malaj
2. Denis Asllani

• **Kandidatët e skualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurimit janë:**

1. Eva Ajazi (munges dokumentacioni)

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).
- Njohuritë mbi Marrëveshjen Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton

dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së, për Shqipërinë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD).

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

- A.** Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën **21.10.2021, ora 10.30**, në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollësia”, Nr. 56, Tiranë.
- B.** Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datë **21.10.2021, ora 11:30** dhe në vazhdim, në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollësia”, Nr. 56, Tiranë. Kandidatët do të paraqiten në intervistë sipas rendit alfabetik.

TË GJITHË KANDIDATËT PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT.

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL